



Agjencia për Migracion e
Republikës së Maqedonisë

DORACAK

me informacione të dobishme
për mërgimtarët nga Maqedonia
(udhëzues praktik)

HYRJE:

Në pajtim me kompetencat e Agjencisë për Migracion që të kujdeset për pozitën, të drejtat dhe interesat e mërgatës nga Maqedonia, Agjencioni për Migracion në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë-Drejtoria e rigjistrisë të gjendjes civile, Sektorin e Policisë kufitare dhe migrimit dhe Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidore të Republikës së Maqedonisë, përgatit Doracak për mërgimtarët nga Maqedonia.

Me rëndësi të veçantë është që në vazhdimësi të punohet në përmirësimin e komunikimit dhe informimit për të gjitha pyetjet e rëndësishme nga jeta shoqërore, politike dhe ekonomike në Republikën e Maqedonisë, por edhe në realizimin e të drejtave të cilat ju takojnë juve mërgimtarë nga Maqedonia në Republikën e Maqedonisë. Poashtu ky është njëri nga parakushtet e rëndësishme për inkuadrimin tuaj aktive në jetën ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të bashkëpunimit të deritanishëm dhe kontakteve me ju dhe analizës së pyetjeve tuaja më shpesh të parashtruara, kemi identifikuar fushat që janë me interes të veçantë për ju.

Doracaku përbëhet nga pesë fusha të interesit, kështu që çdo fushë ka informacione themelore, që më pastaj, përmes pyetjeve të parashtruara me përgjigje, në mënyrë të kuptueshme dhe të thjeshtë të ju ndihmojmë ta merrni informacionin e saktë.

Bëhet fjalë për fushat në vijim:

- » Shtetësia e Republikës së Maqedonisë,
- » Dokumentet personale,
- » Evidenca amë e shtetasve të Republikës së Maqedonisë,
- » Të drejtat dhe obligimet e mërgimtarëve nga Maqedonia për hyrje në Republikën e Maqedonisë, të cilët nuk posedojnë shtetësi të Republikës së Maqedonisë.
- » Sigurimi pensional dhe invalidor dhe marrëveshjet bilaterale për sigurimin social të Republikës së Maqedonisë me shtet ku jetojnë dhe punojnë mërgimtarët nga Maqedonia.

Qëllimi është që në një vend të ofrohen informacionet për procedurat ligjore ekzistuese, kështu që për çdo fushë janë dhënë të dhëna për kontakt me institucionet kompetente, të cilët marrin pjesë në zbatimin e këtyre procedurave. Singërisht, shpresojmë që në këtë doracak do të gjeni informacione të dobishme, të cilat do ta lehtësojnë komunikimin Tuaj me institucionet shtetërore, me çka do të përmirësohet dhënia e shërbimeve cilësore dhe profesionale.

Në fund, Agjencioni për Migracion ju fton për bashkëpunim më intensiv dhe dhënie të propozimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e përmbajtjes së këtij doracaku dhe avancimin e bashkëpunimit tonë të mëtejshëm.

**Agjencia për Migracion
Drejtor, Nikolla Shallvarionov**

PËRMBAJTJA:

Botues:

Agjencia për Migracion e Republikës së Maqedonisë

Për botuesin:

Agjencioni për Migracion i Republikës së Maqedonisë i kryen punët dhe detyrat të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe pozitën e mërgimtarëve nga Maqedonia, ndihmon në zhvillimin kulturor të tyre dhe avancimin e lidhjeve me ta dhe organizatat e tyre, njohjen e mërgimtarëve nga Maqedonia me gjendjen në Republikën e Maqedonisë, krijimin e kushteve për përfshirjen e mërgimtarëve në jetën publike dhe ekonomike në Republikën e Maqedonisë edhe punët tjera të përcaktuara me ligj.

Tekstin e ka përgatitur:

Spektori për çështje juridike dhe ekonomike dhe ri-integrimin e mërgimtarëve nga Maqedonia

Përpunimi teknik:

Agjencia për Migracion, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë-Drejtoria e rigjistrimit të gjendjes civile, Spektori i Policisë kufitare dhe migrimit, Fondi për Çështje Pensional dhe Invalidore, Shoqata për marketing, tregti dhe shërbime AD VALUE DOOEL Shkup.

Tirazhi:

300

Shtetësia e Republikës së Maqedonisë

6

Dokumentet personale

14

Evidenca amë e shtetasve të Republikës së Maqedonisë

20

Të drejtat dhe obligimet e mërgimtarëve nga Maqedonia për hyrje në Republikën e Maqedonisë, të cilët nuk posedojnë shtetësi të Republikës së Maqedonisë

26

Sigurimi pensional dhe invalidor dhe marrëveshjet bilaterale për sigurimin social të Republikës së Maqedonisë me shtet ku jetojnë dhe punojnë mërgimtarët nga Maqedoni

30

1 Shtetësia e Republikës së Maqedonisë

INFORMACIONET THEMELORE

Materia e shtetësisë është e rregulluar me Ligjin për shtetësi të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër. 67/92, 8/04, 98/08, 158/11 dhe 55/2016”) dhe Vendimin për përcaktimin e kritereve të veçanta shkencore, ekonomike, kulturore, sportive ose me interes tjetër kombëtar për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (Gaz. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 9/05, 161/2012).

Me këtë ligj rregullohet mënyra dhe kushtet për marrjen dhe ndërprerjen e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, përcaktimin e shtetësisë, organi shtetëror kompetent për zgjidhjen e këtyre rasteve, dëshmimi i shtetësisë dhe mbajtja e shënimeve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Shtetësia është lidhje juridike në mes Jush dhe shtetit dhe nuk e përcakton origjinën tuaj etnike.

Ligji lejon posedim të shtetësisë edhe të një shteti tjetër - **shtetësi të dyfishtë**.

Në Republikës së Maqedonisë konsideroheni vetëm si shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Shtetasi i cili njëherë e ka fituar shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, nuk mund t’i humbet, as nuk mund t’i merret.

Nëse personi nuk është në evidencën e shtetasve të Republikës së Maqedonisë, ai duhet të parashtojë kërkesë për përcaktimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të dhënat për përcaktim do t’i regjistrojë në evidencën e shtetasve të Republikës së Maqedonisë.

Kërkesë për fitim, pushim ose përcaktim të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë parashtrohet sipas vendbanimit të personit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose nëse personi jeton jashtë vendit, në Përfaqësitë Diplomatike ose Konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

Shtetësi të Republikës së Maqedonisë, mërgimtarët nga Maqedonia mund të fitojnë në mënyrat në vijim: **me origjinë, natyralizim, fitim përsëri i shtetësisë dhe fitim të shtetësisë me martesë- një huaji i martuar me shtetas të Maqedonisë.**

Çka është shtetësia me origjinë?

Fëmija i juaj fiton shtetësi të Republikës së Maqedonisë me origjinë, në rast se të dy prindërit janë shtetas të Republikës së Maqedonisë, pavarësisht ku ka lindur.

Me origjinë, fëmija i Juaj i cili është lindur jashtë vendit, mund ta fitojë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, në qoftë se njëri prej juve prindërve është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Shtetësi të Republikës së Maqedonisë me origjinë fiton edhe i adaptuar me adaptim të plotë të të cilit të dy ose njëri adaptues është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

A do të fitojë shtetësi të Republikës së Maqedonisë fëmija i lindur jashtë vendit, të të cilit njëri prind është shtetas i Republikës së Maqedonisë, ndërsa tjetri shtetas i huaj?

Me origjinë fëmija do të fitojë shtetësi të Republikës së Maqedonisë, nëse deri sa të mbushë 18 vjet, nga ana juaj është paraqitur për regjistrim si shtetas i Republikës së Maqedonisë ose deri sa të mbushë 18 vjet vazhdimisht qëndron në Republikën e Maqedonisë me prindin i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Në qoftë se fëmija i juaj, nuk është paraqitur nga ana juaj për regjistrim si shtetas i Republikës së Maqedonisë, me mbushje 18 vjet deri në mbushje 23 vjet mund personalisht të parashtrorë fletëparaqitje për regjistrim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Fëmija i cili fiton shtetësi të Republikës së Maqedonisë në këtë bazë, konsiderohet shtetas i Republikës së Maqedonisë nga momenti i lindjes.

Çka duhet të bëj nëse fëmija im është lindur jashtë vendit?

Duhet të parashtroni kërkesë për regjistrim në librat e të lindurve dhe në regjistrin e shtetasve në zyrën e shërbimit të gjendjes civile në vendbanimin e prindit, i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë. Nëse jeni jashtë vendit, lindjet duhet t'i paraqitni në ambasadën ose konsullatën më të afërt të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

Çka nëse adaptoj fëmijë?

Fëmija i juaj i adaptuar plotësisht, gjithashtu do të fitojë shtetësi të Republikës së Maqedonisë me origjinë, në qoftë se të dy prindërit ose njëri nga prindërit është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

A mund fëmija të parashtron kërkesë për pranim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë?

Jo, fëmija më i vogël se 18 vjet, fiton shtetësi të Republikës së Maqedonisë përmes prindërve të tij, por mbani mend se prindërit duhet të shënojnë të dhënat e fëmijës në kërkesën e tyre.

Çka do të thotë natyralizim?

Nëse si i rritur, vullnetarisht fitoni shtetësi të shtetit në të cilën qëndroni, pasi që i keni përmbush të gjitha kushtet nga ligji i atij shtetit, atëherë ju e keni fituar shtetësinë me natyralizim. Në Republikën e Maqedonisë, shtetësi me natyralizim mund të bëhet para së gjithash në bazë të viteve të qëndrimit ligjor ose martesës me shtetas të Republikës së Maqedonisë. Nëse e fitoni shtetësinë e Republikës së Maqedonisë me natyralizim, fëmijët tuaj të mitur, gjithashtu do të fitojnë të njëjtën shtetësi, por duhet të shënohen të dhënat për ato dhe duhet të bashkëngjiteni në kërkesën tuaj për pranim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Cilët janë kushtet e privilegjara për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë me natyralizim?

Me natyralizim, mërgimtari nga Republika e Maqedonisë, si dhe pasardhësi i tij i brezit të parë, mund të fitojë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë me natyralizim. Mërgimtarët dhe pasardhësit e tyre të brezit të parë mund të fitojnë shtetësi të dyfishtë, përkatësisht, përveç shtetësisë që e posedojnë edhe shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Në procedurën për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë në bazë të kësaj, duhet të vërtetohet, a jeni mërgimtarë nga Republika e Maqedonisë ose pasardhës i brezit të parë i mërgimtarit nga Republika e Maqedonisë.

A mund i huaj i cili është në martesë me shtetas të Republikës së Maqedonisë të fiton shtetësi të Republikës së Maqedonisë dhe çka duhet të plotësojë?

Shtetësi të Republikës së Maqedonisë në bazë të martesës, mund të fitojë i huaji i cili është martuar me shtetas të Republikës së Maqedonisë, së paku tre vjet dhe deri në parashtrimin e kërkesës, ligjërisht dhe vazhdimisht të ketë jetuar në territorin e Republikën e Maqedonisë, së paku 1 vjet.

I huaj i cili është i martuar me shtetas të Republikës së Maqedonisë më së paku tetë vite, i cili ligjërisht dhe vazhdimisht jeton jashtë vendit dhe me Republikën e Maqedonisë ka lidhshmëri të fuqishme dhe efektive mund të fiton shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

A mund si i huaj të fitoj shtetësi të Republikës së Maqedonisë, ndërsa jam me origjinë nga Maqedonia?

I huaji, me origjinë nga Maqedonia, i cili nuk është mërgimtarë nga Maqedonia, as pas

ardhës i tij i brezit të parë, mund të fitojë shtetësi të Republikës së Maqedonisë, me natyralizim, nëse kjo paraqet interes tjetër të veçantë nacional dhe i plotëson kushtet në vijim:

- » të jetë me origjinë nga Republika e Maqedonisë, ndërkaq jeton jashtë kufijve të shtetit të tij dhe të njohë gjuhën maqedonase,
- » ka dhënë kontribut pozitiv në veprimtarinë publike për histori, politikë dhe zhvillim ekonomik të Republikës së Maqedonisë,
- » nndërmerr aktivitete me të cilat e afirmon Republikën e Maqedonisë jashtë vendit dhe
- » është aktiv në shoqatat dhe bashkësitë e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

Nëse ka interes të veçantë nacional, në varshmëri nga kompetencat e përcaktuara i vlerëson Agjencioni për Migracion (për mërgimtarët nga Republika e Maqedonisë), Ministria e Punëve të Jashtme (për pakicat nacionale maqedonase) dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

A mundet mërgimtarët që kanë të drejtën e shtetësisë të Republikës së Maqedonisë të fillojnë me procedurën për fitimin e saj në përfaqësitë më të afërta diplomatike dhe konsullore dhe cilët dokumente nevojiten?

Po, mërgimtarët mund të parashtrojnë kërkesë dhe të fillojnë procedurën në Përfaqësitë diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit dhe të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- » Kërkesë për shtetësi (formulari i jepet në Përfaqësi diplomatike dhe konsullore);
- » Çertifikatë nga Libri amë i të lindurve në formularë internacionale (nëse është dhënë nga organi i huaj, jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- » Çertifikatë nga Libri amë i të kurorëzuarve, në formularë internacionale (nëse është dhënë nga organ i huaj, jo më i vjetër se gjashtë muaj);
- » Dëshmi për zgjidhjen e çështjes banesore-juridike në Republikën e Maqedonisë;
- » Dëshmi për burim të përhershëm dhe lartësinë e mjeteve për të ekzistuar (vërtetim për lartësinë e rrogës ose pensionit);

» Dëshmi për njohjen e gjuhës maqedonase (nëse parashtruesi i ka vijuar mësimet në Republikën e Maqedonisë, si dëshmi nënkuptohet dëftesa originale ose kopje e verifikuar në noter).

A duhet të paguaj tarifën për fitimin e shtetësisë?

Po, duhet të paguani tarifën administrative prej 100 euro. Para se të parashtroni kërkesë duhet të paguani 20 euro dhe pjesën tjetër të mbetur prej 80 euro duhet ta paguani nëse e fitoni shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, para se të merrni vendimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose në Përfaqësinë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

Në cilët raste mundet të jem i liruar nga pagesa e tarifës administrative para parashtrimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë?

Nëse punohet për pranim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë me interes nacional, me kërkesën tuaj mund të jeni i liruar nga pagesa e tarifës administrative.

A mund të më pushon shtetësia e Republikës së Maqedonisë?

Po, nëse kërkon të hiqni dorë nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë, atëherë duhet të keni shtetësi të huaj ose të dëshmoni se do të pranoheni në shtetësi të huaj (këtë dëshmi e dorëzoni Ju dhe duhet të përkthehet në gjuhën maqedonase e verifikuar në noter).

Dëshmitë tjera sigurohen sipas detyrës zyrtare.

Kam humbur të drejtën e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, a mund përsëri të parashtoj kërkesë për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë?

Në qoftë se e keni humbur të drejtën e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe përsëri kërkon pranim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë, duhet të respektoni afatin ligjor, së paku 3 vjet nga humbja e të drejtës deri në datën e paraqitjes së kërkesës për ri-pranim në shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

Kam për qëllim të investojë në Republikën e Maqedonisë, por jam i huaj dhe a mund kështu të pajisem me shtetësi të Republikës së Maqedonisë?

Në bazë të këtij ligji i huaji i cili do të investojë në Republikën e Maqedonisë në shumë prej 400.000 euro për person si investim të drejtpërdrejtë në kapacitet e reja, me përjashtim në objekte hotelerie dhe kapacitete tregtare, me të punësuar dhjetë persona në kohë të pacaktuar, në një periudhë prej 1 viti, mund të parashtron kërkesë për marrjen e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

Përveç këtij kriteri, ekziston interes i veçantë ekonomik, nëse i huaji është:

- » Menaxher i dalluar në nivel botërorë,
- » ekspert i dalluar i teknologjive të cilat nuk zbatohen në Republikën e Maqedonisë,
- » është ekspertë i lëmisë e cila është deficitare me kuadër përkatës,
- » realizon bashkëpunim ekonomik me subjektet afariste nga Republika e Maqedonisë,
- » realizon investime të drejtpërdrejta në objekte afariste ekzistuese, në ndërtim të kapaciteteve të reja në shtet ose në letra me vlerë afatgjate,
- » investon në fushën e pronësisë industriale, njohuri dhe përvojë, inovacione dhe zhvillim teknologjik,
- » Kontribuon në promovimin e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë jashtë vendit, dhe
- » donon ose kontribuon për donimin e mjeteve për realizimin e reformave ekonomike dhe prioritetet tjera në Republikën e Maqedonisë.

Kush e sjell Vendim për të drejtën e fitimit ose përcaktimit të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe si dorëzohet?

Vendimin për fitimin ose përcaktimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë e sjell Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa dorëzimi bëhet personalisht.

2 Dokumentet Personale (pasaporta dhe letërnjoftim)

Pasaporta është dokument elektronik për identifikim personal i cili i jepet shtetasit të Republikës së Maqedonisë për arsye udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit, si dhe për kthimin në shtet.

Letërnjoftimi është dokument publik me të cilin e dëshmon identitetin, shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, vendbanimin dhe adresën e qytetarit të Republikës së Maqedonisë.

Ku mund të jepet pasaporta?

Dokument udhëtimi për shtetasin e Republikës së Maqedonisë i cili jeton jashtë vendit mund të jepet në Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore si vijojnë: Melburn, Kanbera, Çikago, Toronto, Berlin, Bon, Munihi, Stokholm, Kopenhagë, Hagë, Bruksel, Bernë, Londër, Venedik, Vjenë dhe Lubjanë.

Stacionet mobile për administrim me dokumente të udhëtimit qëndrojnë tri herë në vit në këto përfaqësi, në pajtim me planin e veprimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Cilët lloje të dokumenteve të udhëtimit ekzistojnë?

Ekzistojnë shumë lloje të dokumenteve të udhëtimit edhe atë: pasaportë, pasaportë e përbashkët, pasaportë zyrtarë dhe fletudhëtim, si dhe dokumente udhëtimi të cilët jepen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Çka është fletudhëtimi, për çka shërben dhe a ka afat të vlefshmërisë?

Fletudhëtimi është dokument personal i cili i jepet shtetasit të Republikës së Maqedonisë, i cili lëshohet në rast të humbjes së dokumentit të udhëtimit jashtë vendit dhe i jepet vetëm për t'u kthyer në shtet.

Ku mund të marrin fletudhëtimin mërgimtarët dhe cilët dokumente janë të nevojshme?

Fletudhëtimin e lëshon Përfaqësia diplomatike ose konsullore e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit për shtetasin e Republikës së Maqedonisë, i cili ka ngelur pa dokument udhëtimi, jashtë vendit. Me telefon ose në formë elektronike i bëhet kontroll për statusin e shtetësisë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Fletudhëtimi i jepet, me afat të vlefshmërisë deri më 30 ditë ose vetëm për një udhëtim njëdrejtimësh për kthimin në Republikën e Maqedonisë.

A mund mërgimtari nga Maqedonia i cili jeton jashtë vendit më shumë se gjashtë muaj, të parashtrijë kërkesë për lëshimin e pasaportës në Përfaqësi diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit?

Shtetasi i Republikës së Maqedonisë i cili qëndron jashtë vendit pandërprerë më shumë se 6 muaj, mund të parashtrijë kërkesë për lëshimin e pasaportës në Përfaqësi diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

Ku janë stacionet mobile për lëshimin e një pasaporte?

Në pajtim me Planin e veprimit të përgatitur nga Ministria e Punëve të Jashtme, pasaportat pranohen dhe lëshohen në Melburn, Kanberë, Çikago, Njujork, Detroit, Toronto, Berlin, Bon, Muni, Stokholm, Kopenhagë, Hagë, Bruksel, Londër, Paris, Venedik, Vjenë, Lubjanë.

Cilat dokumente duhet të parashtrihen për lëshimin e dokumentit të udhëtimit në Përfaqësinë diplomatike ose konsullore?

Për lëshimin e pasaportës në Përfaqësitë Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Maqedonisë nevojiten të njëjtat dokumente si në Republikën e Maqedonisë, dhe atë, aplikimi për pasaportë fillon me plotësimin e:

- » kërkesës për lëshim të pasaportës (kërkesën mund ta gjeni në zyrat e Përfaqësisë diplomatike ose konsullore),
- » letërnjoftim ose dokument tjetër publik nga i cili mund të vërtetohet identiteti i parashtruesit të kërkesës, ndërsa për personat që nuk kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, i shtohet letërnjoftimi i lëshuar nga organi kompetent i shtetit të huaj ose dokument tjetër publik nga i cili mund të vërtetohet identiteti i tij;
- » fletëpagesë për formularin e pasaportës dhe shuma e paraparë me tarifën konsullore;

Ka edhe një mundësi të pagesës pa të holla të gatshme.

A mund fëmija nën moshën 18 vjeç të dorëzojë kërkesë për lëshimin e dokumentit të udhëtimit?

Kërkesë për lëshim të pasaportës personit të mitur, përkatësisht personit i cili është me aftësi të kufizuara, i parashtron njëri prej prindërve, përkatësisht kujdestari, nëse personi është nën kujdestari të cilën e dëshmon me vendim.

Në rast se prindërit janë të shkurorëzuar ose të drejtën e prindit e kryen njëri nga prindërit, kërkesën për lëshim të pasaportës për persona të mitur nën 18 vjet e parashtron prindi të cilit i është besuar kujdestaria dhe edukimi, me pëlqim edhe të prindit tjetër.

Nëse prindi tjetër është kundër dhënies së dokumentit të udhëtimit, atëherë kërkohet

mendim nga Qendra për punë sociale.

A mund të refuzohet kërkesa e parashtruar për pasaportë dhe në cilët raste?

Parashtrimi i kërkesës për lëshimin e pasaportës do të refuzohet dhe nuk do të jepet pasaporta në rastet në vijim:

- » nëse kundër personit i cili kërkon pasaportë është ngritur procedurë penale në kërkim nga gjykatës kompetent,
- » nëse personi i cili kërkon pasaportë është i dënuar me burg të pakushtëzuar derisa ta vuaj dënimin
- » nëse atë e kërkon Qendra për punë sociale në lidhje me kryerjen e mbikëqyrjes mbi të drejtën e atësisë dhe çështjet e kujdestarisë, në pajtim me Ligjin për familjen.
- » nëse është sjell kërkesa për ndjekje të procedurës penale
- » nëse personit i pushon shtetësia e Republikës së Maqedonisë.

Në qoftë se aplikoni për një pasaportë në Përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit, ku duhet të merret pasaporta e gatshme dhe në çfarë kohe?

Lëshimi i pasaportës bëhet në Përfaqësinë diplomatike konsullore, ku është dorëzuar kërkesa dhe atë më së voni 90 ditë nga dita e parashtrimin të kërkesës me parashtrimin e dokumenteve të nevojshme.

Nëse mërgimtari e ka humbur pasaportën ose fletudhëtimin jashtë vendit, çka duhet të bëjë dhe ku duhet të drejtohet dhe në çfarë kohe mund të aplikojë për pasaportë ose fletudhëtim?

Nëse mërgimtari e humb pasaportën jashtë vendit është i detyruar menjëherë të paraqitet në Përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit dhe mundet menjëherë të paraqitet për të marrë një pasaportë të dyfishte ose fletudhëtim.

Çka është letërnjoftimi dhe a mund mërgimtarët nga Maqedonia të posedojnë letërnjoftim?

Letërnjoftimi është dokument publik me të cilin e dëshmon identitetin, shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, vendbanimin dhe adresën e qytetarit të Republikës së Maqedonisë.

donisë.

Mërgimtari mund të posedojë letërnjoftim të Republikës së Maqedonisë, nëse ka jetuar në Republikën e Maqedonisë edhe pasi ka migruar jashtë vendit. Nëse personi është i lindur jashtë vendit dhe asnjëherë nuk ka jetuar në Republikën e Maqedonisë nuk mund të merr letërnjoftim sepse nuk ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë.

Kam një letërnjoftim nga koha kur kam jetuar në Republikën e Maqedonisë, tani jam mërgimtarë dhe shumë vite jetoj jashtë vendit, a mund të më jepet letërnjoftim i ri, sepse e vjetra është me afat të vlefshmërisë të skaduar?

Kur letërnjoftimit të vjetër i ka skaduar afati, ndërsa ju jetoni jashtë vendit nuk mund të merrni një të re, nëse jeni paraqitur se keni migruar dhe jetoni jashtë vendit. Nëse ktheheni në Republikën e Maqedonisë atëherë mund të merrni përsëri vendbanim dhe të fitoni letërnjoftim.

A e përcakton letërnjoftimi i mërgimtarit edhe vendbanimin e tij?

Për t'u lëshuar letërnjoftim të Republikës së Maqedonisë, paraprakisht duhet të keni paraqitur vendbanimin e regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

Çka duhet të bëj nëse nuk jetoj në Republikën e Maqedonisë dhe jetoj jashtë vendit më shumë se 3 muaj?

Nëse nuk jetoni në Republikën e Maqedonisë më shumë se tre muaj, ju duhet të parashtroni **Aplikim të qytetarit për qëndrim jashtë vendit më shumë se tre muaj.**

Ku mund të paraqitet Aplikimi i qytetarit për qëndrim jashtë vendit më shumë se tre muaj?

Aplikimi i qytetarit për qëndrim jashtë vendit më shumë se tre muaj, mund të merret dhe paraqitet në organin kompetent në vendin e banimit, në çdo pikë të kalimit kufitar ose në Përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit (Ambasada ose konsullata) ku ai qëndron.

Çka duhet të bëj në qoftë se kthehem në Republikën e Maqedonisë?

Ju jeni të detyruar të paraqitni kthimin tuaj në Republikën e Maqedonisë, në afat prej 3 ditësh nga dita e kthimit në vendin e banimit në Republikën e Maqedonisë.

3

Evidenca amë

Të dhënat themelore për qytetarët i regjistrohen në: Librin amë të të lindurve, Librin amë të të martuarve dhe librin amë të të vdekurve. Librat amë dhe certifikatat dhe vërtetimet që jepen në bazë të Librave amë janë dokumente publike.

Librat amë i mban Zyra për librat amë dhe organet tjera në raste të përcaktuara me Ligjin për evidencën amë.

Regjistrat mbahen veçmas për çdo vendbanim, sipas njësisë civile që i përcakton Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga i punësuarit zyrtar (ofiqari)

Me përjashtim, regjistri i të martuarve kryhet në një vendbanim të caktuar për martesë.

Çka duhet të bëj, nëse më lind fëmijë në shtetin ku jetoj, në mërgim, ndërsa jam shtetas i Maqedonisë?

Në rast se jetoni jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë gjatë kohë dhe Ju ka lindur fëmija atje, mund të parashtroni kërkesë për regjistrimin e tij në Librat amë të të lindurve në Republikën e Maqedonisë, në njësinë amë ku keni pasur adresën e fundit për banim para se të largoheni nga Republika e Maqedonisë.

Përse është e rëndësishme fëmija im i lindur jashtë vendit të regjistrohet në Librin amë të të lindurve në Republikën e Maqedonisë?

Me vetë regjistrimin e fëmijës tuaj në Librin amë të të lindurve, përveç se fëmija do të fitojë certifikatë nga libri amë i të lindurve nga Republika e Maqedonisë, njëkohësisht do të fitojë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë dhe Numrin amë në Maqedoni.

Cilët dokumente më duhen për të parashtruar kërkesën për regjistrimin e fëmijës tim në Librin amë të të lindurve?

Dokumenti më i rëndësishëm i cili është i nevojshëm për regjistrimin e fëmijës është të bashkëngjitni certifikatë origjinale të lindjes me vulë apostil të përkthyer në gjuhën maqedonase, (në rast se nuk është në formular ndërkombëtar, ose nëse ka ndonjë shkronjë e cila nuk ekziston në alfabetin maqedonas), (kopje të certifikatës Tuaj nga libri amë i të martuarve në rast se jeni të martuar, kopje të dokumenteve tuaja të identifikimit të vlefshme (pasaportë, letërnjoftim) dhe një pëlqim nga prindi i cili është shtetas i huaj për regjistrimin e fëmijës në Librin amë të të lindurve dhe në Librin e shtetasit të Republikës së Maqedonisë.

A ka afat për parashtrim të kërkesës për regjistrim të fëmijës tim në Librin amë të të lindurve?

Nuk ekziston afat i përcaktuar saktë në të cilin jeni të detyruar të regjistroni fëmijën Tuaj në Librin amë të të lindurve.

Në cilën mënyrë mund të parashtrorj kërkesë për regjistrimin e fëmijës tim në Librin amë të të lindurve?

Ekzistojnë tre mënyra për regjistrimin e fëmijës Tuaj në Librin amë të të lindurve.

Mënyra e parë është që Ju personalisht të parashtroni kërkesë për regjistrimin e fëmijës Tuaj në sportelet e Zyrës për menaxhim me librat amë të të lindurve në Republikën e Maqedonisë.

Mënyra e dytë është që të parashtroni kërkesë nëpërmjet Përfaqësive Diplomatike ose Konsullore të Republikës së Maqedonisë.

Gjithashtu ekziston mundësi të autorizoni ndonjë me Autorizim të verifikuar në noter/ose të verifikuar në ambasadën e Maqedonisë i cili në emrin Tuaj kryen paraqitjen e fëmijës Tuaj dhe të mund ai person të marrë certifikatën nga libri amë i të lindurve për fëmijën Tuaj.

A ekziston ndonjë mënyrë e vetme që njëri prind të parashtrorj kërkesë personalisht për regjistrim plotësues të fëmijës tim?

Gjithsesi ekziston mënyrë, është e nevojshme që prindi t'i posedojë të gjitha dokumentet e lartpërmendura në pyetjen nr. 4.

Jetoj jashtë vendit gjatë kohë, por më duhet certifikatë e re nga Libri amë i të lindurve. Si mund të nxjerr certifikatë të re nga Libri amë i të lindurve?

Ekzistojnë tre mënyra për parashtrim të kërkesës për certifikatë nga Libri amë i të lindurve/bashkëshortëve/vdekurve. Njëra mënyrë është personalisht në sportelet e Zyrës për menaxhim me librat amë, e dyta është me autorizim të verifikuar në noter/ambasadën e Maqedonisë i cili në emrin Tuaj do të parashtrorj kërkesë për lëshimin e certifikatës nga Libri amë i të lindurve,/martuarve/vdekurve ose nëpërmjet Përfaqësive Diplomatike ose Konsullore të Republikës së Maqedonisë që janë me seli në shtetin ku jetoni.

Libri amë i të martuarve

Si mund të regjistrorj martesën e lidhur jashtë vendit?

Ekzistojnë tre mënyra për regjistrimin e martesës Tuaj të lidhur jashtë vendit.

Mënyra e parë është të vini personalisht në sportelet e Zyrës për menaxhim me librat amë, e dyta mënyrë është që të autorizoni ndonjë person me autorizim të verifikuar në noter ose në ambasadën e Maqedonisë që në emrin Tuaj të parashtrorj kërkesë dhe të mund ta marrë certifikatën e martesës maqedonase. Mënyra e tretë është nëpërmjet Përfaqësive diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë, me seli në shtetin ku jetoni.

Cilat dokumente më duhen për ta regjistruar martesën e lidhur jashtë vendit?

Ju duhet të bashkëngjitni certifikatë për kurorëzim me vulë apostile (e përkthyer në gjuhën maqedonase, në rast se nuk është në formularë ndërkombëtar ose ka ndonjë shkronjë që nuk ekziston në alfabetin maqedonas), kopje të letërnjoftimeve dhe pasaportave Tuaja të vlefshme dhe deklaratë të nuses gjatë lidhjes së kurorës se cilin mbiemër do ta mbajë.

A ka ndonjë afat për regjistrimin e martesës së lidhur jashtë vendit?

Nuk ka afat të caktuar për regjistrimin e martesës, por megjithatë mënyra më e shpejtë dhe e pëlqyeshme është përputhja e të dhënave me institucionet që udhëhiqen në Republikën e Maqedonisë me evidencat zyrtare jashtë vendit.

Libri amë i të vdekurve

Si mund të regjistrorj personin e ndjerë jashtë vendit në Librin e të vdekurve?

Në pajtim me ligjin për evidencën amë, çdo person mund të parashtrorj kërkesë për regjistrimin e vdekjes, megjithatë certifikatën nga libri amë të të vdekurve mund ta marrë vetëm trashëgimtari ligjor i të ndjerit.

Cilët dokumente janë të nevojshme për të regjistruar ndonjë person që ka vdekur jashtë vendit?

Ju duhet të bashkëngjitni certifikatën origjinale nga libri amë i të vdekurve me vulë apostile (të përkthyer në gjuhën maqedonase, në rast se nuk është në formularë ndërkombëtar ose nëse ka ndonjë shkronjë që nuk ekziston në alfabetin maqedonas), një kopje nga dokumenti i vlefshëm për identifikim i të ndjerit, kopje të certifikatës së lindjes/kurorëzimit të të ndjerit.

Si mund ta regjistrorj personin e ndjerë jashtë vendit?

Ekzistojnë tri mënyra për të regjistruar faktin e vdekjes së kryer jashtë vendit.

Mënyra e parë është të vini personalisht në sportelet e Drejtorisë për udhëheqjen e li-

brave amë, mënyra e dytë është të autorizoni ndonjë person me autorizim të noterizuar në noter ose në Ambasadën e Republikës së Maqedonisë, në emrin tuaj të parashtrojë kërkesë për regjistrim të vdekjes në librin amë të të vdekurve dhe të mund të marrë certifikatën e vdekjes në Maqedoni. Mënyra e tretë është nëpërmjet Përfaqësisë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë që gjendet në shtetin ku jetoni.

4

Të drejtat dhe detyrimet e mërgimtarëve nga Maqedonia për hyrje në Maqedoni të cilët nuk kanë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë

Të drejtat dhe detyrimet e mërgimtarëve nga Maqedonia për hyrje në Maqedoni të cilët nuk kanë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë

Cilët detyrime i kanë mërgimtarët nga Maqedonia, pa shtetësi të Republikës së Maqedonisë, kur të vijnë në Republikën e Maqedonisë?

Ju, edhe pse jeni me origjinë nga Maqedonia, në Republikën e Maqedonisë jeni të huaj sepse nuk keni shtetësi të Republikës së Maqedonisë dhe jeni të detyruar të paraqitni qëndrimin tuaj në Republikën e Maqedonisë. Vendqëndrimi është vend në të cilin ju qëndroni përkohësisht gjatë qëndrimit tuaj në Republikën e Maqedonisë.

Cili më saktësisht e ka obligim të paraqet vendqëndrimin për këto qytetar në varësi se ku qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë?

Çështja e paraqitjes së mërgimtarëve nga Maqedonia, të cilët nuk kanë shtetësi të Republikës së Maqedonisë është rregulluar me Ligjin për të huajt.

Vendqëndrimi në kuptim të këtij ligji është vendi në të cilin mërgimtari - i huaji qëndron përkohësisht gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Maqedonisë.

Obligimi për paraqitjen e të huajit në qoftë se qëndron në Republikën e Maqedonisë në një hotel, motel, apo objekt tjetër të cilët janë në pronësi të personit juridik është i personit të autorizuar të personit juridik.

Personat tjerë (banorët e Republikës së Maqedonisë) tek të cilët qëndrojnë të huajt janë të detyruar që të paraqesin qëndrimin e të huajit në afat prej 48 orësh nga ora e ardhjes së të huajit, në stacionin policor kompetent.

Çka duhet të bëj që të marr leje për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë, edhe pse jam mërgimtarë nga Maqedonia, por nuk kam shtetësi të Republikës së Maqedonisë?

Duke pasur parasysh se nuk keni shtetësi të Republikës së Maqedonisë, ju jeni i huaj dhe për të marrë leje për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë duhet t'i plotësoni kushtet në vijim:

- » të keni të mjete të mjaftueshme për jetesë, gjegjësisht ushqimin e keni të siguruar në mënyrë tjetër ligjore,
- » të keni siguruar strehim apo të keni të mjete për strehim,
- » të keni sigurim shëndetësor,
- » të keni plotësuar të gjitha kushtet e parapara për disa lloje të lejeve për qëndrim të përkohshëm (në bazë të rregullimit të qëndrimit të përkohshëm sipas origjinës, dëshmi se personi është me origjinë nga Republika e Maqedonisë).

Të drejtat dhe detyrimet e mërgimtarëve nga Maqedonia për hyrje në Maqedoni të cilët nuk kanë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë

Vendim për heqje dorë nga shtetësia e deritanishme, Vendim për heqje dorë nga shtetësia e prindërve të të huajit.

E kam ndërmend të qëndroj në Republikën e Maqedonisë pa prindërit e mi dhe jam 18 vjet dhe nuk kam shtetësi të Republikës së Maqedonisë, çka duhet të bëj që të marr leje për qëndrim?

I huaji, i cili është në moshë deri 18 vjet dhe ka për qëllim të qëndrojë në Republikën e Maqedonisë i pa shoqëruar nga prindi, gjegjësisht kujdestari, ndër të tjera duhet të bashkëngjesë edhe lejen nga prindërit të verifikuar, gjegjësisht nga kujdestari për qëndrim në Republikën e Maqedonisë.

5

Sigurimi pensional dhe invalidor dhe marrëveshja bilaterale për sigurimin social të RM me vendet ku jetojnë dhe punojnë mërgimtarët nga Maqedonia

INFORMACIONET THEMELORE

Republika e Maqedonisë, me qëllim që t'i mbrojë qytetarët e saj jashtë vendit, me shtetet tjera ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare për sigurim social.

Me zbatimin e tyre, qytetarët e Republikës së Maqedonisë që janë të punësuar apo qëndrojnë jashtë vendit, si dhe me anëtarët e familjeve të tyre, të drejtat e tyre i realizojnë në bazë të punës, gjegjësisht me sigurim në vend të huaj, ndërsa në forma të caktuar me sigurim social.

Me sigurimin pensional dhe invalidor sipas marrëveshjeve ndërkombëtare sigurohet e drejta e pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar.

Republika e Maqedonisë pas pavarësimit i nënshkroi dhe janë në zbatim marrëveshjet për sigurim social me shtetet, në vijim: Kroacia, Austria, Turqia, Sllovenia, Gjermania, Zvicra, Bullgaria, RS Jugosllavi (zbatohet për Serbi), Bosnja Hercegovinë, Çekia, Holanda, Polonia, Romania, Luksemburgu, Belgjika, Australia, Mali i Zi, Kanadaja, Hungaria, Republika e Sllovakisë dhe Republika e Shqipërisë dhe Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës së pensionit.

Pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë vazhdojnë të zbatohen marrëveshjet e marra nga ish-Jugosllavia edhe atë: Franca, Italia, Britania e Madhe, Irlanda, Norvegjia, Suedia dhe Danimarka.

Cilët janë kushtet për pension të pleqërisë të Maqedonisë?

Personi i siguruar e fiton të drejtën e pensionit, kur ai i mbush 64 vjet (për meshkujt), gjegjësisht 62 vjet (për femra) dhe së paku 15 vjet stazh pensional.

Cilat dokumente nevojiten për parashtrimin e kërkesës për pension të pleqërisë?

Për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë ju nevojiten dokumentet në vijim:

» librezë pune dhe dëshmi për stazhin e pensionimit që nuk është i shkruar në librezën e punës,

- » certifikatë të lindjes ndërkombëtare nga Libri amë i të lindurve,
- » vërtetim për kryerjen e shërbimit ushtarak për meshkuj, dhe
- » një llogari transaksioni nga banka ku do të transferohet pensioni IBAN dhe SWIFT kod

Cilat janë kushtet për pension invalidor të Maqedonisë?

Personi i siguruar tek i cili do të paraqitet paaftësi e përgjithshme për punë, si dhe i siguruari me aftësi të kufizuar për punë, i cili për arsye të arritjes së viteve të caktuara të jetës, me rehabilitim profesional nuk mund të aftësohet për punë tjetër përkatëse e fiton të drejtën e pensionit invalidor nëse i plotëson kushtet e parapara nga këndvështrimi i stazhit për pensionim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

Cilët dokumente më nevojiten për pension invalidor?

Nevojiten të njëjtat dokumente si për pension të pleqërisë dhe dokument plotësues duhet të dorëzoni dokumentacion medicinal.

Cilat janë kushtet për pension familjarë të Maqedonisë?

Pension familjar mund të realizojnë personat në vijim: bashkëshorti, fëmijët (të lindur në martesë ose jashtë martese ose të adaptuar, fëmijët për të cilët i siguruari është kujdesur, nipërit dhe fëmijët tjerë pa prindër për të cilët i siguruari është kujdesur), prindërit (babai dhe nëna, njerku dhe njerka) dhe adaptuesi, për të cilët i siguruari është kujdesur.

Pension familjar mund të realizon edhe bashkëshorti i shkurorëzuar, nëse me vendim gjyqësor i është përcaktuar e drejta përkujdesit.

Anëtarët e familjes e fitojnë të drejtën e pensionit familjar, nëse i siguruari i vdekur ka së paku 5 vite stazh të sigurimit apo ka qenë shfrytëzues i pensionit të pleqërisë apo invalidor.

Cilat dokumente nevojiten për aplikim për pension familjar?

Nevojiten dokumentet në vijim:

- » Librezë pune dhe dëshmi për stazhin e pensionimit që nuk është i evidentuar në librezën e punës, nëse e drejta e pensionit realizohet pas vdekjes së të siguarit aktiv.
- » Certifikatë ndërkombëtare të lindjes nga Libri amë i të lindurve, për të gjithë anëtarët e familjes për të cilët kërkohet pranimi i të drejtës së pensionit familjar.
- » Certifikatë ndërkombëtare të kurorëzimit nga Libri amë i të martuarve për të ve

dhe vejushë për të cilët kërkohet pranimi i të drejtës së pensionit familjar (certifikata duhet të lëshohet pas vdekjes së të siguarit dhe shfrytëzuesit të pensionit)

- » Certifikatë ndërkombëtare të vdekjes nga Libri amë i të vdekurve
- » Dëshmi për ndjekjen e mësimi të fëmijëve më të mëdhenj se 15 vjet, dhe
- » Një llogari transaksioni nga banka ku do të transferohet pensioni.

Ku parashtrohet kërkesa për realizimin e të drejtës së pensionit të Maqedonisë?

BKërkesën për realizimin e të drejtës së pensionit të Maqedonisë i siguruari/parashtruesi e parashtron në institucionin kompetent gjegjësisht organin që merret me palët me të cilat Republika e Maqedonisë ka të nënshkruar marrëveshje, ndërsa i siguruari/parashtruesi ka vendbanim të përhershëm, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

Ku do të më paguhet pensioni i Maqedonisë, nëse jam mërgimtar dhe jetoj jashtë vendit?

Shfrytëzuesi i pensionit- shtetas i Republikës së Maqedonisë i cili do të shpërngulet jashtë vendit, pensioni dhe të ardhurat tjera i paguhen jashtë vendit, nëse një detyrim i tillë është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare.

Nëse një detyrim i tillë nuk është i përcaktuar, atëherë drejtori i fondit sjell vendim për pagesën e pensionit sipas mendimit të tij.

Çka duhet të paraqes si dëshmi për ngritjen e procedurës për transferimin e pensionit?

- » Kërkesë me shkrim
- » Vërtetim për shtetësi
- » Llogari devizore nga banka ku do të transferohet pensioni
- » Një kopje nga vendimi për pension

Jam shfrytëzues i pensionit të Maqedonisë, ndërsa jam mërgimtarë dhe jetoj jashtë Republikës së Maqedonisë, cilët obligime tjera i kam që të më paguhet rregullisht pensioni?

Shfrytëzuesit e pensionit të Maqedonisë të cilët jetojnë jashtë Republikës së Maqedonisë duhet detyrimisht të paraqiten dy herë në vit edhe atë në muajin prill dhe tetor, detyrimisht duhet të dërgojnë Vërtetim për jetë në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Vërtetimi për jetë mund ta merrni në Ueb faqen e FSPIM.

ADRESAR I INSTI- TUCIONEVE NË REPUB- LIKËN E MAQEDONISË

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

www.vlada.mk

MINISTRIA E PUNËVE TË BREDSHME

www.mvr.gov.mk

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

www.mfa.gov.com

MINISTRIA E PUNËS DHE PLOTIKËS SOCIALE

www.mtsp.gov.mk

AGJENCIA PËR MIGRACION

www.emigration.gov.mk

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

www.piom.com.mk



Agjencia për Migracion e Republikës së Maqedonisë
Shkup, maj 2018